

## RELACION

### PËR PROJEKTLIGJIN

#### “PËR ARBITRAZHIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Arbitrazhi është një nga mënyrat alternative dhe efikase të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Karakteristikë themelore e arbitrazhit është zgjedhja private dhe jashtë juridiksionit gjyqësor të mosmarrëveshjeve. Bizneset dhe jo vetëm, janë të interesuara në zgjedhjen e shpejtë dhe jo-burokratike të mosmarrëveshjeve. Procedura e arbitrazhit është transparente dhe ofron mjete të kontrollit të procedurës nga palët. Si përparësitë kryesore të arbitrazhit ndaj gjykatave, konsiderohen: (i) fleksibiliteti; (ii) efikasiteti në kohë dhe shpenzime; (iii) plotëfuqishmëria e vendimit të arbitrazhit dhe (iv) konfidencialiteti i procedurës dhe vendimeve.

Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8687, datë 09.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit” në Konventën Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961, si dhe me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 ka aderuar “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, New York, datë 10.06.1958.

Nëpërmjet këtyre akteve, Shqipëria është radhitur në krah të atyre vendeve juridikisht të qytetëruara, duke u bërë pjesë e konventave ndërkombëtare, me qëllim rregullimin e fushës së arbitrazhit dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në pajtim me standardet bashkëkohore Evropiane dhe ndërkombëtare.

Arbitrazhi ka qenë pjesë edhe sistemit ligjor vendas nëpërmjet rregullimeve të miratuara në përmbajtjen e Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996. Megjithëkëtë, këto parashikime janë shfuqizuar me ligjin Nr.112/2013, datë 18.04.2013. Në këto kushte, rezulton se jemi përpara një ometimi ligjor, pasi kapitulli mbi arbitrazhin që përmbante Kodi i Procedurës Civile është shfuqizuar dhe nga ana tjetër nuk është miratuar asnjë një rregullim

tjetër specifik për të. Për rrjedhojë, ekzistenca e një vakumi ligjor që nga viti 2013 ka pasur një efekt negativ në drejtim të zhvillimit të proceseve të arbitrazhit nga gjykatat e arbitrazhit vendase.

Duke u nisur nga sa më sipër, në mungesë një ligji të posaçëm, është e rëndësishme që Shqipëria të përgatitë kornizën ligjore për rregullimin e arbitrazhit. Ndaj, përcaktimi i rregullave kombëtare për zhvillimin e arbitrazhit është vlerësuar si një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, në drejtim të konsolidimit të shtetit të së drejtës, garantimit të të drejtave të njeriut, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve midis shtetit dhe palëve private, apo palëve private me njëra-tjetrën dhe kundrejt detyrimeve të marra përsipër ndërkombtarisht.

### **Qëllimi kryesor i këtij projekt-akti është:**

- ruajta e koherencës/harmonizimi i legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, lidhur me fushën e arbitrazhit.
- përmirësimi i procedurave të gjykimit dhe rritja e efikasitetit në trajtimin e konflikteve duke ofruar zgjidhje më të shpejta të probleme të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.
- përcaktimi i rregullave për marrëveshjen e arbitrazhit, në përputhje me parashikimet e rregullave model të UNCITRAL dhe të Konventës së Nju Jorkut.
- njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit.

Efektet që synon iniciativa propozuese janë të tilla që rregullojnë në tërësi kuadrin ligjor duke gjetur një zgjidhje fleksibël, afatgjatë dhe të gjithëpranuar.

### **Objektivat e përgjithshëm janë:**

- a) Përafrimi i legjislacionit shqiptar me të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.
- b) Përmirësimi i kuadrin ligjor shqiptar për arbitrazhin, procedurat e zbatimit dhe implementimin e tij në Shqipëri.
- c) Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parime për rregullimin e arbitrazhit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke krijuar një bazë ligjore të nevojshme dhe të domosdoshme, për ushtrimin e profesionit të arbitrit, rregullat e procedurat e zhvillimit të procedimeve të arbitrazhit, të cilat janë të përcaktuara sipas vullnetit të palëve dhe mjetet juridike me anë të cilit

shpreh qëndrimin e saj gjykata e arbitrazhit dhe kriteret e pamundësisë së njohjes apo ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit.

- d) Njohja dhe zbatimi i të drejtës së arbitrazhit në Shqipëri.
- e) Hartimi dhe miratimi i projektligjit për arbitrazhin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar synon ndër të tjera dhe promovimin e tij si një nga metodat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve, duke derg
- f) Aplikimi i rregullave që ndërlidhen me zbatimin e ligjit për arbitrazhin në kontekstin kombëtar dhe përcaktimi i saktë i juridiksionit. Çështja e juridiksionit ka një rëndësi thelbësore procedurale, pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ, pasi mospërcaktimi i saktë i faktit nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në atë të arbitrazhit lidhet me fatin e çështjes dhe zgjidhjen përfundimtare të saj, duke qenë se mosrespektimi i juridiksionit mund të çojë në prishjen e vendimit.

### **Objektivat specifike që synohen të arrihen janë:**

1. Të krijohet besimi që do të jepet një vendim i drejtë dhe i paanshëm.

Në kushtet që arbitrazhi zhvillohet me anë të një procedure të pavarur, çka do të thotë se nuk ndikohet nga institucionet e tjera shtetërore, përbën një avantazh dhe do të rrisë besimin e palëve për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të paanshëm.

2. Të krijohet një sistem më fleksibël dhe funksional për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Arbitrazhi është një proces më fleksibël krahasuar me një proces gjyqësor dhe thelbësisht i ndryshme nga ato të procedurave të **shqyrtimit në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor**. Arbitrazhi nuk është pjesë e sistemit shtetëror të gjykatave Sikurse u trajtua dhe më sipër, edhe pse arbitrazhi mbështetet në një procedurë konsensuale mbështetur në parashikimet e marrëveshjes së, funksioni që realizon është i njëjtë me atë sistemit të gjykatave. Është e rëndësishme të kuptohet qartë që shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit. Kjo heqje dorë e palëve kontraktuese nga juridiksioni gjyqësor dhe dëshira për t'ia nënshtruar gjykimin e

mosmarrëveshjeve që lindin mes tyre arbitrazhit bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për zgjidhjen e problemeve të krijuara mes tyre një zgjidhje më të shpejtë, më efektive dhe më pak të kushtueshme. Në përfundim të procesit konkludohet me vendim nga gjykata arbitrazhi i cili përbën titull ekzekutiv sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile.

3. Ulja e shpenzimeve dhe pakësimi i formaliteteve e burokracive, në zgjidhjen e një konflikti.

Një nga argumentet më të rëndësishëm që influencon në promovimin e arbitrazhit si një nga format alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhet me faktin se vendimet që sigurohen nëpërmjet tij janë vendime më të shpejta dhe kanë një kosto më të ulët në krahasim me proceset gjyqësore. Mos efikasiteti dhe zvarritja që i karakterizon gjykatat shtetërore ka motivuar palët që mosmarrëveshjet e tyre t'ia besojnë për zgjidhje arbitrazhit.

4. Ruajtja e të dhënave personale, duke ruajtur konfidencialitetin, neutralitetin dhe mos publikimin e të dhënave personale.

Natyra private e arbitrazhit çon gjithashtu në konfidencialitetin e procesit. Kjo do të thotë që as palët, arbitrat, dëshmitarët, ekspertët nuk duhet të zbulojnë asgjë rreth arbitrazhit.

5. Inkurajimi i investimeve ndërkombëtare dhe i tregtisë.

Arbitrazhi ndërkombëtar është ndërtuar me qëllimin për t'i siguruar palëve, të cilët u përkasin juridiksioneve të ndryshme, që mosmarrëveshja e tyre do të trajtohet dhe zgjidhet në mënyrë neutrale. Palët që janë pjesëmarrës në një marrëveshje ndërkombëtare të arbitrazhit kërkojnë që arbitri, të mos jetë i lidhur me asnjë prej vendeve juridike kombëtare në konflikt si dhe të mos ketë ndikime prej tyre. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ata kërkojnë aplikimin nga arbitrat të rregullave proceduralë ndërkombëtare neutrale. Gjithashtu dhe garantimi i parimit të barazisë së palëve në proces<sup>1</sup> ndikon në rritjen e investimeve të huaja në vend.

---

<sup>1</sup> Neni 8 i Ligjit model të UNICITRAL: Palët do të trajtohen me barazi dhe secilës palë do ti jepet një mundësi e plotë për të paraqitur çështjen e tij.

6. Mundësia e zgjedhjes së lirë të disa alternativave për të zgjidhur një konflikt.

Ndërmarrja e nismës për hartimin e projektligjit “Për Arbitrazhin” u jep mundësi palëve që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në të ardhmen të mos i drejtohen vetëm gjykatës si mënyra e vetme për zgjidhjen e tyre, por të kenë mundësi për të pasur dhe metoda të tjera alternative për zgjidhjen e konflikteve. Arsyet se përse palët mund të zgjedhin arbitrazhin janë nga më të ndryshmet. Së pari, arbitrazhi i jep mundësi palëve që të zgjedhin persona me njohuri të specializuara për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre. Së dyti, arbitrat zgjidhen për një mosmarrëveshje të veçantë, dhe me zgjidhjen e saj ata shpërndahen. Së treti, arbitrazhi nuk i nënshtrohet apelimit përsa i përket themelit të konfliktit.

7. Kufizimet në kompetencat gjyqësore kur palët kanë zgjedhur arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në rastin kur palët kanë zgjedhur arbitrazhin si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve midis tyre, vendimi i dhënë nga arbitrat do të përbëjë një vendim final dhe detyrues. Por në zbatim të nenit 5 të Konventës së Nju Jorkut, pavarësisht se konflikti është zgjidhur përmes marrëveshjes së arbitrazhit, janë gjykatat shtetërore ato të cilat kanë kompetencë të përcaktojë se në arbitrazh është ndjekur procedura e duhur, duke ushtruar autoritetin e tyre për të anuluar një vendim arbitrazhi apo për të refuzuar njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit.

8. Rregullimi ligjor i arbitrazhit ndërkombëtar.

Vendimet e arbitrazhit janë të zbatueshme njëjloj si vendimet e gjykatës. Konventa e Nju Jorku-ut garanton njohjen dhe zbatimin forcërisht të vendimit, nëpërmjet një autorizimi të dhënë nga një gjykatë e shtetit, ku pala humbëse ka selinë. Kjo e bën arbitrazhin tregtar ndërkombëtar të favorshëm ndaj komunitetit ndërkombëtar të biznesit<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> Neni 35/1 i Ligjit model të UNICITRAL: Një vendim arbitrazhi, pavarësisht nga vendi në të cilin është marrë, duhet të njihet si i detyrueshëm, dhe nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës kompetente, duhet të detyrojë forcërisht subjektet përkatëse, të detyruar sipas vetë vendimit.

## **II. VLERËSIM I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.**

Propozimi i kësaj nisme vjen si nevojë e përbushjes së detyrimeve që burojnë nga një sërë aktesh ndërkombëtare si Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe Konventa Evropiane e Arbitrazhit. Nisma hartohet në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, miratuar me Vendimin Nr. 773, datë 2.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017–2020 dhe të Planit të saj të Veprimit”.

Pikërisht në vijim të analizës së këtyre dokumenteve kyçe politike, Ministria e Drejtësisë ka përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projekt akteve, që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, miratuar me vendimin nr. 837, datë 24.12.2019, është parashikuar për 4 - mujorin e I, edhe propozimi i projekligjit “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Projektligji rregullon arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar të zhvilluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, bazuar kryesisht në modelin e ligjit për arbitrazhin ndërkombëtar të UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare) dhe legjislacionet te tjera si ai i Gjermanisë, Italisë, Spanjës, Francës, Kosovës, Kroacisë, Lituanisë dhe Hungarisë.

Në kuadër të sa më sipër, vlerësohet se miratimi i këtij projektligji dhe një mjedis i mirërregulluar i fushës së arbitrazhit do të sillte impakt pozitiv për të gjitha grupet e interesit, ku vlen të veçohet komuniteti i investitorëve dhe bizneseve të huaja në vend, zhvillimi i mëtejshëm i të cilëve do të pasjellë më shumë të hyra në buxhetin e shtetit dhe ndikime pozitive në ekonominë e vendit, duke i mundësuar këssoj qeverisë të kryejë më shumë investime publike.

Përfitimet e drejtpërdrejta që kanë grupet e interesi i parashtrajmë si më poshtë:

- Neutraliteti i arbitrazhit ndërkombëtar, që u mundëson palëve të zgjidhin përmes arbitrazhit mosmarrëveshjet e karakterit tregtar ndërkombëtar, edhe pse vijnë nga vendet e ndryshme, në bazë të autonomisë së vullnetit të tyre të zgjedhin vendin, kohën, arbitrat, rregullat, gjuhën në të cilën do të zhvillohet procedura para arbitrazhit tregtar ndërkombëtar, gjëra që nuk mund të bëhen para gjykatave shtetërore;
- Shmangia e formaliteteve dhe fleksibiliteti përmes arbitrazhit;
- Zgjidhja e shpejtë dhe efikase e mosmarrëveshjeve me anë të procedurës së arbitrazhit;
- Konfidencialiteti pasi si rregull vendimet e arbitrazhit nuk publikohen, në dallim nga procesi gjyqësor i cili mbështetet në parimin e gjykimit me dyer të hapura;
- Mundësia e zgjedhjes së arbitrave nga vet palët paraqet një përparësi të madhe të arbitrazhit në raport me gjykatat e rregullta;
- Pavarësia e gjykatës së arbitrazhit në punën e tij. Kjo përparësi e arbitrazhit nënkupton atë se organet e tjera shtetërore, e në veçanti gjykatat, nuk mund të ndërhyjnë në juridiksionin e arbitrazhit.
- Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit paraqet përparësinë e radhës së këtij institucioni kundrejt gjykatave të rregullta.

Miratimi i këtij projektligji do të sillte rezultate pozitive në drejtim të konsolidimit të kuadrit ligjor për arbitrazhin. Varësisht se në cilë fazë është procedura kjo korinzë përfshinë Ligji për Arbitrazhin, Kodin e Procedurës Civile, dhe Ligjin për Përmbarrim.

Projektligji përmban dispozita që rregullojnë si arbitrazhin e brendshëm ashtu edhe ndërkombëtar.

Projektligji përmban dispozita ku përfshihen të përshtatura parashikimet e Konventës së Nju Jorkut, konkretisht dispozitat që rregullojnë në parim detyrimin e shtetit për të njohur vendimin dhe marrëveshjen e arbitrazhit, si dhe dispozitat që rregullojnë paraqitjen e kërkesës për njohje. Gjithashtu, projektligji merr në konsideratë parashikimeve të ligjit model UNCITRAL, të cilat jo vetëm që nuk bien ndesh me parashikimet e Konventës së Nju Jorkut, por përmirësojnë më tej procedurat e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me parimet kushtetuese, me parashikimet përkatëse të Kodit të Procedurës Civile dhe me legjislacionin në fuqi.

Hartimi dhe miratimi i ligjit për arbitrazhin gëzon mbështetje kushtetuese, për shkak se nëpërmjet tij sigurohet garantimi i parimit për një proces të rregullt ligjor. Funkcionimi normal i arbitrazhit, si mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ndikon ndjeshëm në efikasitetin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor, duke vënë në zbatim parimin kushtetues sipas të cilit kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (neni 42/2 i Kushtetutës).

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE**

Miratimi i projektligjit nuk ka ndikim përse i përket procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me at të BE-së duke qenë se nuk ekzistojnë norma të *acquis* (të tilla si Rregullore ose Direktiva) të cilat rregullojnë drejtpërdrejtë çështjet e arbitrazhit në vendet anëtare të Bashkimit Europian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Projektligji rregullon arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar, bazuar kryesisht në modelin e ligjit për arbitrazhin ndërkombëtar të UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare).

Projektligji i propozuar është i strukturuar në 8 krerë dhe përbëhet nga 65 nene.

**KREU I “Dispozita të përgjithshme”** përcakton dispozitat e përgjithshme që përfshijnë objektin e qëllimin e ligjit, si dhe përkufizimet e përdorura në projektligj, ku vlen të përmendet përkufizimi i termit “arbitrazh” si dhe



diferencimi ndërmjet “arbitrazhit vendas”, që përfshin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet dy palëve vendase, dhe “arbitrazhit ndërkombëtar”, që përfshin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve që veprojnë në shtete të ndryshme në përputhje me parashikimet e nenit 1, paragrafi 3 të ligjit model UNCITRAL.

Projektligji për Arbitrazhin aplikohet për të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomike-juridike, përveç nëse është e ndaluar me ligj. Mosmarrëveshjet të cilat nuk i takojnë këtyre dy kategorive (civile – juridike dhe ekonomike – juridike) nuk mund t’i nënshtrohen arbitrazhit. Fushëveprimi i gjerë i projektligjit është në pajtim me Modelin e UNCITRAL-it për ligjin për arbitrazh (neni 1), që thekson se termi “tregtar” duhet të interpretohet në atë mënyrë që të trajtojë çështjet që rrjedhin nga të gjitha marrëdhëniet e natyrëstregtare, pavarësisht faktit nëse ato janë apo nuk janë të natyrës kontraktuale.

Pavarësisht nga rregullat e këtij projektligji, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e (i) marrëdhënieve familjare; (ii) sendet e paluajtshme; (iii) falimentimim.

**KREU II** “*Institucionet e arbitrazhit*” mundëson organizimin e procedurave të arbitrazhit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në arbitrazh institucional (“të administruar”) dhe arbitrazh *ad hoc*.

*Arbitrazhi ad hoc* – është gjykatë e zgjedhur që themelohet në bazë të kontratës së palëve me qëllim që të zgjidhë një mosmarrëveshje të caktuar.

*Arbitrazhi institucional* – është organizatë jofitimprurëse, e themeluar sipas legjisllacioneve në fuqi, që të ushtrojë funksionin e gjykatës së zgjedhur, nëse palët në mosmarrëveshje i drejtohen.

Përparësitë kryesore të arbitrazhit institucional janë se procesin e menaxhon institucioni i cili përcakton rregullat e procedurës, tarifën, mirëmban një trup arbitrash për të cilët poashtu përcakton standardet.

Edhe arbitrazhi *ad hoc* (“*i paadministruar*”) po ashtu ka disa përparësi të tilla si – është më pak i kushtueshëm për shkak se nuk ngarkon tarifën e tij – palët paguajnë

vetëm arbitrat dhe ato kanë fleksibilitet më të madh në zgjedhjen e tyre dhe në përcaktimin e procedurës, sidoqoftë tek kjo formë në mungesë të menaxhimit institucional ekziston barrë më e madhe mbi palët dhe arbitrat. Palëve dhe arbitrave pa përvojë në përgjithësi u mungon njohuria dhe ekspertiza për të organizuar arbitrazhin në mënyrë efektive, gjë që mund të rezultojë në moszgjidhjen me kohë të mosmarrëveshjes që në fakt do të shtojë koston e përgjithshme të procesit për zgjidhjen e kontestit. Rrezik tjetër është se vendimi i arbitrazhit mund të jetë i gabueshëm dhe gjykata nuk do ta njohë atë. Arbitrazhi institucional mund të parandalojë pengesat e mësipërme duke verifikuar draftin e vendimit përpara se të nxirret gjë që mundëson përmirësimin e gabimeve.

**KREU III “Marrëveshja e arbitrazhit”** normon rregullat e zbatueshme për lidhjen e marrëveshjes së arbitrazhit, përfshirë palët dhe objektin e marrëveshjes që mund të lidhet midis tyre, formën e marrëveshjes së arbitrazhit dhe juridiksionin e rolin e gjykatës në shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit.

Neni 12, i projektligjit parashikon rregulla të posaçme mbi formën e kërkuar për lidhjen e marrëveshjes së arbitrazhit, e cila duhet të bëhet me shkrim. Veçantia e këtij neni është që parashikon rregulla të detajuara për formën e marrëveshjes në përputhje me parashikimet e nenit 7 të ligjit model të UNCITRAL, përmbushin njëkohësisht parimet e përgjithshme mbi ‘Kontratat’ të nenit 659 e vijues të Kodit Civil. Në këtë drejtim marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë në formën e një kontrate të veçantë ndërmjet palëve si dhe në formën e një klauzole të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh të përfshirë në kontratën e lidhur midis palëve.

Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë praktikën e zakonshme tregtare vendase dhe ndërkombëtare, marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet se është lidhur me shkrim edhe nëse është pjesë e një akti të nënshkruar nga palët ose nëse lidhja e marrëveshjes së arbitrazhit dokumentohet në shkëmbimin e letrave, fakseve, telegrameve, postës elektronike apo mjeteve të tjera të komunikimit ose regjistrimit të të dhënave, të cilat mund të dokumentohen dhe sigurojnë një provë të marrëveshjes së arbitrazhit, si dhe nëse përfshihet në një akt të dërguar nga njëra palë tek tjetra ose të dërguar nga një person i tretë tek të dyja palët, i cili nuk është kundërshtuar nga palët ose njëra palë brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Një rast tjetër i posaçëm është kur kontrata midis palëve bën referim të drejtpërdrejt në një dokument tjetër që përmban klauzolën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me

arbitrazh, parashikim që ndeshet jo vetëm në ligjin model të UNCITRAL por edhe në dispozitat mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Polonisë dhe Sllovenisë.

Domosdoshmëria e formës së marrëveshjes vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë **juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme.**

Projektligji për Arbitrazhin në nenin 14 të këtij Kreu si dhe në terësinë e përmbajtjes së tij parashikon 4 situata kur gjykatat kanë të drejtë të ndërhyjnë në punën e arbitrazhit: a) emërimi, zëvendësimi dhe përjashtimi i arbitrave, b) juridiksioni i tribunalit, c) anulimi i vendimeve të arbitrazhit dhe d) marrja e masës së sigurimit të padisë. Këto situata janë mjaft të ndjeshme ku gjykata duhet marrë parasysh parime si mos-ndërhyrja në procedurën e arbitrazhit, respektimi i autonomisë së vullnetit të palëve, rregullat e institucionit që administron arbitrazhin, sigurinë juridike për palët etj. Si përfundim, vendosja e standardeve për ndërhyrjen e gjykatave në arbitrazh është e një rëndësie primare për sistemin e drejtësisë dhe rregullimi në projektligj është vlerësuar me kujdes **në mënyrë që të arrihej siguri juridike për palët, besueshmëri në arbitrazh si metodë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ruajtje e kredibilitetit për gjykatat.** Ushtrimi i këtyre kompetencave për ndërhyrje nga gjykatat bazohet në parime dhe standarde që pasqyrojnë interesat e sistemit drejtësisë, komunitetit gjyqësor dhe biznesit e personave tjerë. Këto parashikime janë bërë në përputhje me parashikimet e neneve 17, 17.A, 17.B, 17.C, 17.D, 17.E, 17.F, 17.G, 17.H, 17.I, dhe 17.J të ligjit model UNCITRAL.

**KREU IV “Përbërja e gjykatës së arbitrazhit”** parashikon rregullat e zbatueshme për kushtet që duhet të plotësojë arbitri, numri i tyre, emërimin, përjashtimin si dhe zëvendësimin e Arbitrave në përputhje me parashikimet e neneve 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 të ligjit model UNCITRAL dhe që janë të ngjashme me dispozitat mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Polonisë, Sllovenisë, Lituanisë.

Neni 16, i projektligjit përmban rregullat mbi numrin e arbitrave, i cili si rregull duhet të jetë numër tek për aq sa palët nuk janë dakordësuar ndryshe. Ndërkohë, neni 17, i projektligjit parashikon rregullat e zbatueshme për emërimin e arbitrave,

ku në rast të arbitrit të vetëm ky i fundit emërohet me dakordësi të palëve dhe në rast të trupit gjykues me tre arbitra, secila palë emëron një arbitër dhe dy arbitrat e emëruar nga palët emërojnë arbitrin e tretë. Në të dyja rastet nëse dakordësia nuk gjendet brenda 30 ditëve, arbitri emërohet nga Gjykata e rrethit gjyqësor e vendit ku ndodhet arbitrazhi me kërkesë të të dyja palëve ose të njëjës palë.

Neni 18 parashikon raste kur një arbitër mund të zëvendësohet, bashkë me procedura dhe afatat për zëvendësimin e arbitrit.

Neni 19 parashikon se arbitri i duhet të pranojë detyrën, në mënyrë që gjykata të jetë formuar rregullisht.

Neni 20 parashikon për përgjegjësinë e arbitrit, i cili mban përgjegjësi për dëmet që u shkakton palëve me dashje apo pakujdesi të rëndë për ato veprime a mosveprime të cila kanë ndikuar pozitën e palëve. Këtyre të fundit u lind e drejta për të kërkuar dëmshpërblim sipas procedurës së përcaktuar me ligj dhe nëse pranohet përgjegjësia nga arbitri, atij i humb e drejta për të kërkuar pagesën e tarifës dhe rimburimin e shpenzimeve.

Nei 21 parashikon rastet e ndalimit në pjesëmarrje në gjykim, në mënyrë që të garantohet paanshmëria dhe pavarësia e tij në një procedurë arbitrazhi.

Në rast se arbitri bëhet i paaftë ose i pamundur për të përmbushur funksionet e tij, ose nëse lindin dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë ose pavarësinë e arbitrit, nenet 22 dhe 23, të projektligjit parashikojnë për rastet e përjashtimit të arbitrit nëse ekzistojnë shkaqet dhe rethanat e përcaktuara në paragrafët “a”- “ç”, të këtij neni dhe më pas parashikohen procedurat dhe afatat që ndiqen nëse përjasohet arbitri. se palët ose vetë arbitri kanë drejtë të kërkojnë përfundimin e detyrës së arbitrit. Në rast të përfundimit të detyrës së arbitrit, arbitri zëvendësues emërohet në përputhje me rregullat e zbatueshme për emërimin e arbitrit që zëvendësohet sipas parashikimeve të nenit 18, të projektligjit.

**KREU V** “*parimet e arbitrazhit*”, janë përcaktuar parimet që ndjekin arbitrat në trajtimin e bararabte të palëve, në përcaktimin e rregullave procedura le nga institucionet e arbitrazhit, pavarësia e arbitrit, konfidencialiteti i të dhënave dhe procedurave,.

**KREU IV** “*Përgatitja e procedurave të arbitrazhit*” përmban rregullat e zbatueshme përgjatë zhvillimit të procedurave të arbitrazhit nga ana e gjykatës së arbitrazhit në përputhje me parashikimet e neneve 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26

dhe 27 të ligjit model UNCITRAL dhe që janë të ngjashme me dispozitat mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Francës, Kroacisë dhe Sllovenisë. Rregullat e arbitrazhit janë hartuar në mënyrë që të jenë sa më fleksibile për palët dhe që tribunalit t'i shërbejnë në mënyrë sa më efikase për të arritur deri te vendimi përfundimtar

Këto rregulla janë hartuar duke u bazuar në rregullat e mirënjohura të arbitrazheve institucionale dhe ad hoc ndërkombëtare. Këto rregulla të procedurës aplikohen menjherë nëse një marrëveshje e arbitrazhit e referon Republikën e Shqipërisë si vend i arbitrazhit, përjashtimisht situatave kur palët me marrëveshje u janë referuar rregullave të tjera apo rregullave të institucioneve të tjera.

Neni 28 i projektligjit sanksionon aspektin procedural të marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës së arbitrazhit, e cila vendos lidhur me juridiksionin e saj për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, përfshirë mbi ekzistencën apo vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit ose formimin e rregullt të kolegjit të arbitrave. Gjykata disponon mbi çështjet në kompetencën me vendim të ndërmjetëm ose me vendim përfundimtar. Pretendimi për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit mund të ngrihet përpara kësaj gjykate jo më vonë se dita e dorëzimit nga pala të deklaratës së mbrojtjes. Palët kanë të drejtë të paraqesin pretendime lidhur me mungesën e juridiksionit edhe nëse kanë emëruar ose kanë marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Pretendimet lidhur me tejkalimin e kompetencës nga gjykata e arbitrazhit duhet të ngrihen menjëherë sapo çështja pretendohet të jetë jashtë kompetencës së gjykatës së arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund ta pranojë kundërshtimin edhe kur bëhet me vonesë, me kusht që të provohet se vonesa ka qenë për shkaqe të arsyeshme. Nëse palët nuk paraqesin pretendime lidhur me vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit që në aktin e parë të mbrojtjes, pas formimit të gjykatës së arbitrazhit, nuk mundet që, për të njëjtin shkak, të ankimojë vendimin e arbitrazhit, me përjashtim të rastit kur mosmarrëveshja nuk mund të jetë objekt arbitrazhi. Pala që nuk prapëson gjatë procedurave të arbitrazhit se pretendimet e palëve të tjera janë në tejkalim të marrëveshjes së arbitrazhit, nuk mundet që, për të njëjtin shkak, të ankimojë vendimin e arbitrazhit. Kundër vendimeve të ndërmjetme mund të paraqitet ankim në mënyrat dhe afatet e parashikuara për vendimin përfundimtar. Paraqitja e ankimit ndaj një vendimi të ndërmjetëm nuk pezullon procedurën e arbitrazhit, përveç kur gjykata e arbitrazhit vendos ta pezullojë atë deri në vendimmarrjen e gjykatës

neni 29 përcakton për të drejtën e palëve për të paraqitur ankim në mënyrat dhe afatet e parashikuara për vendimin përfundimtar. Paraqitja e ankimit ndaj një vendimi të ndërmjetëm nuk pezullon procedurën e arbitrazhit, përveç kur gjykata e arbitrazhit vendos ta pezullojë atë deri në vendimmarrjen e gjykatës. Gjykata e arbitrazhit, pavarësisht parashikimeve të këtij neni apo nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, mund të mbledhet në çdo vend që e çmon të përshtatshëm, me konsultime ndërmjet arbtrave, dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve, apo në vendin ku do të bëhet këqyrja e sendeve, të luajtshme ose të paluajtshme ose çdo dokumenti tjetër.

Neni 30 parashikon për gjuhën që do të përdoret gjatë procedurës së arbitrazhit. Në rast se palët nuk e kanë caktuar, gjuha që përdoret gjatë procedurës, për çdo shpjegim dhe pretendimi me shkrim të paraqitur nga palët, për çdo seancë dëgjimore, si dhe për çdo vendim ose njoftim tjetër të kryer nga gjykata e së arbitrazhit është ajo e vendit të arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë që çdo provë me shpresë të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën ose gjuhët e caktuara me marrëveshje midis palëve ose të përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit. Në këtë rast, gjykata e arbitrazhit pranon provat e përkthyer vetëm nga një përkthyes i licensuar, i kontraktuar nga secila prej palëve ose i caktuar nga vetë gjykata e arbitrazhit. Kërkesa për arbitrazh, kërkesë padia dhe parashtrimet e tjera mund të bëhen në gjuhën e kontratës që përmban klauzolën e arbitrazhit, të marrëveshjes së arbitrazhit ose në gjuhën shqipe deri në momentin e përcaktimit të gjuhës së përdorur gjatë procedurës së arbitrazhit, përveç kur është rënë dakord ndryshe nga palët.

Neni 31 përcakton rregullat që ndiqen për njoftimin e komunikimeve dhe mënyrat e komunikimit të tyre. Njoftim me shkrim konsiderohet i dërguar, në rast se dërgimi është bërë në përputhje me parashikimet e këtij neni, edhe nëse marrësi refuzon ta pranojë atë, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, sipas shënimit përkatës në aktin e njoftimit. Rregullat e njoftimit sipas këtij neni, nuk zbatohen për proceset gjyqësore, që përcaktohen në Kodine Procedurës Civile.

Neni 32, përcakton mundësinë e përfaqësimit të palëve, personlisht ose përmes përfaqësuesit të autorizuar, i cili zgjidhet me vullnetin e palëve.

Neni 33, i projektligjit parashikon për të drejtën e heqjes dorë nga nga e drejta e kundështimit, ku përcaktohe se Nëse njëra nga palët është në dijeni të shkeljes së një dispozite të këtij ligji apo të mospërbushjes nga pala tjetër të një detyrimi që rrjedh nga marrëveshja e arbitrazhit dhe, pavarësisht kësaj, vijon procedurën e

arbitrazhit, duke mos kundërshtuar menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë nga marrja djeni, shkeljen përkatëse, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për kundërshtim.

**KREU VII** “*procedurat e arbitrazhit*”, përcaktojnë rregullat e zbatueshme gjykimin në arbitrazh, për fillimin e procedurës, përmbajtjen e kërkesës për arbitrazh, njoftimin e fillimit të procedurës, deklarata e mbrojtjes, ndryshimi dhe plotësimi i pretendimeve, seancat dëgjimore dhe procedurat me shkrim, pasoja nga mosveprimi i palëve, provat, dëshimtarët, ekspertët, mbështetja e gjykatës në marrjen e provave, kompensimi, marrja e masave të sigurimit të padisë dhe ankimi ndaj masave të sigurimit.

Neni 34 i projektligjit, përcakton se procedura e arbitrazhit fillon në datën kur institucioni i përhershëm i arbitrazhit merr kërkesën për fillimin e procedurës së arbitrazhit, nëse procedurat e arbitrazhit zhvillohen dhe administrohen nga një institucion përhershëm arbitrazhi; në datën në të cilën kërkesa për arbitrazh i njoftohet palës së paditur, në çdo rast tjetër (arbitrazhi ad hoc), nëse palët nuk kanë parashikuar ndryshe në marrëveshje.

Neni 35 i projektligjit, parashikon elementët formalë të kërkesës dhe zbatimin mutatis mutandis për kundër padinë.

Neni 36 parashikon se menjëherë pas fillimit të procedurës së arbitrazhit, institucioni i përhershëm i arbitrazhit i dërgon të paditurit njoftim për fillimin e procedurave të arbitrazhit dhe kopje të kërkesës për arbitrazh, dhe e informon për të drejtën e tij për të dorëzuar deklaratën e mbrojtjes.

Neni 37, parashikon rregulla për njoftimin e deklaratës së mbrojtjes, pranë institucionit të arbitrazhit, elementë që duhet të përmbajtë deklarata dhe dokumentacionin mbështetës.

Neni 38 i projektligjit përcakton rregullat për zhvillimin e seancës dëgjimore apo vijimi e procedurës vetëm mbi bazën e dokumentacionit apo materialeve të shkruara. Gjykata e arbitrazhit vendos të zhvillojë një seancë dëgjimore kur vlerësohet e arsyeshme, duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, ose mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve. Seancat dëgjimore nuk janë publike, përveç nëse palët kanë rënë dakord ndryshe. Gjithashtu përcaktohen për njoftimin paraprak të palëve brenda një kohë të arsyeshme në lidhje me çdo seancë dëgjimore dhe çdo mbledhje të gjykatës së arbitrazhit e cila ka për qëllim marrjen e provave. Deklaratat, kërkesat, aktet ose informacionet e tjera të cilat njëra palë i dorëzon gjykatës së arbitrazhit i

njoftohen palës tjetër, përfshi këtu edhe çdo raport eksperti ose dokument provues në të cilin gjykata e arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit të saj.

Neni 40 parashikon pasojat e mosveprimit të palëve, ku në rast se paditësi nuk e paraqet kërkesën për arbitrazh në përputhje me nenin 35, gjykata e arbitrazhit përfundon procedurën e arbitrazhit dhe pushon gjykimin. Në rast se i padituri nuk paraqet deklaratën e mbrojtjes në përputhje me nenin 37, gjykata e arbitrazhit vazhdon procedurat, duke mos e vlerësuar mosparaqitjen e këtij dokumenti nga ana të paditurit si pranim nga ana e tij të pretendimeve të paditësit. Nëse një palë nuk paraqitet në seancë ose nuk paraqet prova shkresore brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjykimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura deri në atë moment prej saj, përveçse kur pala ka shkak të arsyeshëm për mosveprimin. Palët mund të bien dakord ndryshe për pasojat që sjell mospërmbushja e detyrimeve sipas këtij neni.

Neni 41 i projektligjit, përcakton barrën e provës për palët, ku secila prej tyre duhet të provojë faktet mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, përveçse ku është parashikuar ndryshe në marrëveshjen mes palëve.

Neni 42, i projektligjit rregullon thirrjen e dëshmitarëve gjatë zhvillimit të seancave të arbitrazhit, nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe. Ky nen përcakton mënyrën e pyetjes së tyre nga gjykata e arbitrazhit. Ndërkohë, neni 43, i projektligjit, i cili rregullon caktimin dhe dëgjimin e ekspertit të caktuar nga palët ose kur e cakton gjykata. Eksperti paraqet raportin e tij me shkrim ose me gojë, mbi bazën e kërkesës së një pale ose nëse gjykata e arbitrazhit e çmon të nevojshme, merr pjesë në seancë, ku palët kanë mundësi t'i bëjnë pyetje dhe të paraqesin dëshmitarë ekspertë mbi fushën për të dëshmuar mbi çështjet në konkrete në gjykim.

Neni 44 përcakton për mbështetjen e gjykatës së arbitrazhit nga gjykatat e faktit për marrjen e provave, në përputhje me legjislacioni procedural civil.

Neni 45 i projektligjit parashikon për mundësin e arbitrave të marrin në shqyrtim kërkesat për kompensim, në kufijtë e vlerës së çështjes, edhe nëse kredia për kompensim nuk përfshihet në fushën e zbatimit të marrëveshjes së arbitrazhit.

Neni 46 i projektligjit përcakton kompetencat e gjykatës së arbitrazhit për të dhënë masat e sigurimit të padisë me kërkesën e njëres prej palëve, përveç kur ka



marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve ose kur kjo nuk lejohet nga ligji i zbatueshëm i zgjedhur nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit. Kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë mund të paraqitet në çdo kohë përpara dhënies së vendimit përfundimtar të arbitrazhit, me akt që i njoftohet palëve dhe arbitrave kur ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

a) pala kërkuese mund të pësojë një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm gjatë kohës së nevojshme deri në lëshimin e vendimit të arbitrazhit;

b) ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit do të bëhej i pamundur apo do të vështirësohej së tepërmi me kushtin që të ekzistojë mundësia e arsyeshme e një vendimi në favor të palës kërkuese.

Kur e vlerëson të përshtatshme, gjykata e arbitrazhit mund të kushtëzojë marrjen e masës së sigurimit me dhënien e një garancie në të holla ose dorëzanie, duke përcaktuar objektin, mënyrën e vënies në garaci dhe afatin. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit që cakton një masë siguri përbën titull ekzekutiv. Në prani të shkaqeve të justifikuara të ndodhura pas vendimit që pranon masën e sigurimit, dhe pasi ka dëgjuar palët, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë heqjen e saj.

Neni 47 përcakton rregullat dhe afatin 10 ditor për ankimin ndaj vendimit të masës së sigurimit, pranë gjykatës së apelit të vendit të arbitrazhit

**KREU VIII** “*Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit*” përmban rregullat e zbatueshme për thelbin e mosmarrëveshjes, mënyrën e marrjes së vendimit nga trupi i arbitrave, formën e përmbajtjen e vendimit të gjykatës së arbitrazhit, njoftimin e vendimit, efektet e vendimit, ekzekutimin e vendimit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, procedurat e reflektimit në procedurën e arbitrazhit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim, përfundimin e procedurave të arbitrazhit, korrigjimin e gabimeve materiale, interpretimin e vendimit dhe vendimin shtesë të arbitrazhit, vendimin e gjykatës së arbitrazhit mbi shpenzimet e procedurës së arbitrazhit në përputhje me parashikimet e neneve 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të ligjit model UNCITRAL dhe që janë të ngjashme me dispozitat mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Polonisë dhe Sllovenisë.

**KREU IX** “*Ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit*” përmban rregullat e zbatueshme për ankimin kundër vendimit të arbitrazhit, rastet kur lejohet ankimi ose shkaqet e pavlefshmërisë, afatin e ankimit shqyrtimin nga ana e gjykatës së apelit, dhënia e vendimit mbi ankimin. Juridiksionin gjyqësor në lidhje me shqyrtimin e ankimit të vendimit si dhe rastet e pavlefshmërisë kur lejohet ankimi në përputhje me

parashikimet e neneve 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të ligjit model UNCITRAL dhe që janë të ngjashme me dispozitat mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Polonisë dhe Sllovenisë. Ajo që vlen të theksohet është se shqyrtimi i ankimit është lënë në diskrecionin e gjykatës së Apelit, në pajtim me këtë projektligj si dhe Kodin e Procedurës Civile.

**KREU X** “*Dispozita kalimtare dhe të fundit*” përmban dispozitat e fundit që rregullojnë mënyrën e referimit në rregulloret e institucioneve të arbitrazhit, dispozitat kalimtare, shfuqizimet dhe momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.

## **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen të gjitha organet publike dhe private.

## **VII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministri i Drejtësisë me asistencën teknike të projektit “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri” (EURALIUS V) dhe do të paraqitet për shqyrtim dhe miratimi pranë Këshillit të Ministrave.

Projektligji i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në dhjetor të vitit 2019, i cili ka qëndruar 20 ditë në regjistër, në pritje të komenteve nga grupet e interesit. Në përmbyllje të afatit ligjor për konsultimin e tij, nuk ka patur komente apo sugjerime për këtë projektligj.

Projektligji është përcjellë për mendim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Avokaturës së Shtetit, ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Gjatë periudhës fillestare të konsultimit, në vijim të kërkesës për mendim të Ministrisë së Drejtësisë, kanë shprehur qëndrimet e tyre, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për shkak se projektligji iu nënshtrua një vlerësimi të kujdesshëm të profesionistëve të drejtësisë si pedagogët së drejtës civile pranë Fakultetit të Drejtësisë, profesorë

të Shkollës së Magjistraturës dhe ekspertë të fushës, të cilët me punën e tyre kanë kontribuar në përmirësimin e draftit të projektligjit, i cili paraqitet sërish për mendim për shkak të ndërhyrjeve që janë bërë.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk përcjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi hedh themelet për një drejtësi private, të orientuara nga palët në një mosmarrëveshje. Duke qenë se arbitrimi është një veprimtari e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, tarifrat, shpenzimet apo shpërblimet janë tërësisht të përcaktuara nga tregu dhe nuk krijojnë efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**ETILDA GJONAJ (SALIU)**